



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT
OSNOVNI SUD PRIZREN – BASIC COURT OF PRIZREN

C.nr.465/08

GJYKATA KOMUNALE NË PRIZREN, me gjyqtaren Shpresa Emra, çështjen juridike të paditëses A. S. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. V. O. nga Prizreni, kundër të paditures KS “D. –I.” nga Prishtina të cilën me autorizim e përfaqëson i autorizuari A. L. nga Prishtina, për kompensim të dëmit, vlera e kontestit 850€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në prezencë të autorizuarve të palëve në kontest, me dt.19.12.2012 mori:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditëses A. S. nga Prizreni, dhe obligohet e paditura KS “D.-I.” nga Prishtina, që paditëses të paguaj :

Për dëmin jomaterial-

-në emër të dhimbjeve fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, të intensitetit të rëndë, të intensitetit të mesëm dhe të ultë shumën prej.....3.000€

-në emër të frikës së intensitetit të lartë, të mesëm dhe të ultë shumën prej2.000€

-në emër të shëmtimit trupor të shkallës së mesëm shumën prej.....2.000€

-në emër të zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej.....2.000€

Për dëmin material

-në emër të ndihmës së personit të huaj shumën prej.....600€

-në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej600€

Në shumë të tërësishme prej10.200€

II. Obligohet e paditura t' i paguaj shumën e tërësishme prej **10.200 €** me kamatë të cilën i paguan Banka për mjetet pa destinacion të caktuar të afatizuar duke filluar nga dita e gjykimit gjer në pagesën përfundimtare.

III. Pjesa e kërkesë padisë e cila është kërkuar në shumë të përgjithshme prej 17.400 € nga pjesa e cila është aprovuar në shumë prej 10.200€ **refuzohet si e pabazuar.**

IV. Obligohet e paditura që paditësit ti kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej **708.64€**, të gjitha në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit.

A r s y e t i m

Paditësja në padi nëpërmjet të autorizuarit të saj ka parashtruar padi për kompensim dëmi duke cekur se me datë 24.08.2007 ka ndodhur aksidenti në fshatin Krusha e Madhe ku ngasësi i automjetit "Opel corsa" B. S. me rastin e hyrjes në kthesë për shkak të shpejtësisë së papërshtatshme e humb kontrollin dhe del jashtë rrugës. Paditësja A. S. ka qenë bashkëudhëtare në automjetin e aksidentuar. Automjeti ka qenë i siguruar te KS "D." .Paditësja në këtë aksident ka pësuar lëndime të rënda trupore si ndrydhje të kokës me plagë gërvishtëse në regjionin e vetullës së djathtë, ndrydhje të krahërorit me thyerjen e brirëve 4,5, dhe 6 si dhe ndrydhje të krahut të djathtë me thyerje të pjesës së poshtme të saj. Si pasojë ka përjetuar frikë, dhimbje, i është zvogluar aktiviteti jetësor dhe është detyruar që të rehabilitohet një kohë. Në fjalën e tij të fundit i autorizuari i paditëses e ka precizuar kërkesë padinë ashtu që në bazë të dokumentacionit mjeksor për lëndimet të cilat i ka pësuar paditësja dhe ekspertizës së ekspertëve ortoped traumatolog dhe neuropsikiatër ka kërkuar që gjykata ta obligoj të paditurin të paguaj kompensim të dëmit jomaterial dhe material në shumë të përgjithshme prej 17.400 €. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë për përpilim të padisë shumën prej 93.60, për tri seanca të mbajtura 365.04 €, shpenzimet për dy ekspertiza mjeksore shumën prej 250€ në shumë të përgjithshme prej 708.64 €.

I autorizuari i të paditurit në përgjigje në padi nuk e ka kontestuar bazën juridike të padisë dhe në këtë drejtim edhe kanë propozuar që të bëhet pajtim jashtëgjyqësor të cilën pala paditëse e ka refuzuar kështu që kontestuese mbetet dhe kontestohet lartësia për llojet e dëmit. Në fjalën e të fundit i autorizuari i paditures ka ngelur në tërësi pranë përgjegjes në padi dhe theksimeve të bëra gjatë procesit kontestimor si dhe sa i përket precizimit të lartësisë së kërkesë padisë të njëjtën e ka kontestuar për lartësi pasi që disa kërkesa nuk janë të bazuara sipas provave që janë aëdministruar në shqyrtim derisa pjesën tjetër të kërkesës sa i përket dëmit jomaterial të njëjtën konteston se është tepër i lart dhe se e njëjta nuk është në harmoni me praktikën gjyqësore për kategoritë dhe shkallën e dëmtimit dhe moshën që ka paditësja.

Gjykata pas vlerësimit të provave të administruara, secilës dhe të gjitha bashkërisht, provat në kuptim të nenit 8 të LPC dhe gjeti se kërkesëpadia e paditëses është **pjesërisht E BAZUAR**

Për vërtetimin e gjendjes faktike, në këtë çështje juridike , gjykata në procedurën e provave ka administruar këto prova: ka bërë leximin e aktgjykimit penal të Gjykatës Komonale në Rahovec P.nr.288/07 të dt.23.04.2008, ka lexuar ekspertizën e komunikacionit dhënë në PPK në Prizren sipas lëndës PP.nr.2242/07 të dt. 19.09.2007, ka lexuar raportin policor nr. 2007-GR-1297 të dt. 24.08.2007 si dhe në fletë pune të aksidentit të komunikacionit të policisë sipas këtij raporti, ka lexuar raportin mjeksor të Spitalit regjional në Prizren nr. 11833 të dt. 24.08.2007, ka bërë shiqimin në raportin mjeksor të ordinancës ortopedike specialistike “Ortopedia” dt. 15.09.2007 dhe 16.11.2007, ka bërë shiqimin në kartelën e mjekimit të shtëpisë së shëndetit për A. S. me nr. 15182, ka bërë shiqimin në konstatimin radiologjik nga ana e kabinetit të radiologjisë në Prizren me dt.04.04.2008, ka bërë shiqimin në raportin mjeksor të dhënë nga ana e Dr. B. K. neurokirurg me dt. 29.03.2008, ka bërë shiqimin në analiza të bëra nga ana e Qendrës së mjeksësisë familjare në Prizren me nr.61dhe 46, ka lexuar raportin e specialistit të ordinancës “Jeta” me datë 15.04.2008 dhe raportin e specialistit të emergjencës me nr.17720 të dt. 09.12.2007, raportin e Ambulancës specialistike “Ortopedia” dt. 18.03.2008 dhe 30.11.2007, fletëudhëzimin 10.03.2008, ka bërë shiqimin në dëftesën e spitalit regjional në Prizren me dt. 22.10.2007, në raportin e specialistit të dt. 15.10.2007, në dëftesën e QKMF në Prizren me datë 10.04.2007, në raportin e anestziologut me dt. 29.08.2007, në raportin e ordinancës ortopedike “Ortopedia” me datë 08.09.2007, ka bërë shiqimin në kuponat tatimor nr. 2490, 2492, 2488, 2427,2426,2428 të gjitha pa emër, në kuponat tatimor 02187, 02186, 02188, 02267, 03173,02435, 01909, të gjitha pa emër dhe pa nënshkrim dhe vulë, ka bërë shiqimin në dëftesën e spitalit regjional në Prizren nr. 105476 të dt. 29.08.2007, nr. 06506 me dt. 04.09.2007 dhe nr. 08268 të dt. 09.11.2007, i ka dëgjuar ekspertët mjeko ligjor dhe atë Dr. Xh. S. ortoped traumatolog dhe N. F. neuropsikiatër në shqyrtim me dt. 05.12.2012 ku edhe e kanë dhënë mendimin e tyre.

Me leximin e raportit policor nr.2007-GR-1297 të dt. 24.08.2007, aktgjykimit penal P.nr.288/07 të dt. 23.04.2008, ekspertizës së komunikacionit të dhënë në PPK në Prizren sipas lëndës PP.nr. 2242/07 të dt. 19.09.2007 gjykata ka vërtetuar se me datën 24.08.2007 në rrugën lokale Rahovec Hoçë e vogël, Krushë e madhe ka ndodhur aksidenti i trafikut ku pjesëmarës në automjet me markën “Opel corsa” ka qenë B. S. ngasësi i automjetit i cili edhe ka shkaktuar aksidentin e trafikut. Ai me një kthesë të ashpër e humb kontrollin mbi automjetin, hudhet jashtë rrugës me ç’ rast si pasojë e aksidentit vjen gjer te dëmi material në automjet dhe lëndime trupore pësojnë bashkëudhëtarja A. S., F. S., R. S. dhe N. S.. B. S. shpallet fajtor dhe denohet me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili denim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 2 viteve nëse nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Me leximin e raporteve mjeksore të cekura më lart gjykata ka vërtetuar se paditësja A. S. së pari është paraqitur në spitalin regjional në Prizren me dt. 24.08.2007 për shkak të lëndimeve të pësuar në aksidentin e trafikut në pjesën e kokës, gjoksit,

krahut të djathtë dhe dorës së djathtë. Më pas nga raportet të parashtruara është vërtetuar se paditësja është mjekuar në vazhdimësi gjatë këtij viti dhe ka pasur raporte të ndryshme specialistike.

Me shiqimin në kuponat tatimor të parashtruara me padi dhe të administruar gjykata nuk ka mund të vërtetohet se të njëjtat janë përdorur për shërimin e paditësës pasi që të gjitha kanë qenë pa emër, pa nënshkrim dhe pa vulë.

Nga shiqimi në dëftesat e Spitalit regjional në Prizren me datë 29.08.2007, 04.09.2007 dhe 09.11.2007 gjykata ka vërtetuar se paditësja është nënshtruar shërimit me terapi fizikale në këtë spital në Departamentin e fiziatrisë.

Me ndëgjimin e mjekut Dr. Xh. S. në shqyrtim me dt. 05.12.2012 dhe dhënies së mendimit të tij në këtë shqyrtim gjykata ka konstatuar se i njëjti pas ekzaminimit drejtpërdrejtë të paditësës si dhe pas shiqimit në dokumentacionin mjekësor të parashtruar është konstatuar se paditësja ka pësuar ndrydhje të kokës me plagë prerëse gërvishtëse të regjionit të vetullës së djathtë, ndrydhje të krahorit të shoqëruar me thyerje të brinjëve 4, 5 dhe 6 të anës së djathtë dhe ndrydhje të krahut të djathtë të shoqëruar me thyerjen e pjesës së poshtme të krahut të djathtë. Këto lëndime janë karakterizuar si lëndime të rënda trupore të cilët kanë shkaktuar dhimbje fizike të të gjitha intensiteteve të cilat i ka edhe sot e kësaj dite mvarësisht nga kushtet klimatike dhe sforcimet fizike. Është vogluar aktiviteti i përgjithshëm jetësor për 20% për shkak të thyerjes së 3 brinjëve. Për shkak të vrazës operatore në brrylin e krahut të djathtë ka shëmtim trupor të shkallës së mesme. Ndihma e huaj ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 70 ditësh dhe ushqimi përforcuar për 3 muaj. Gjithashtu ka qenë i nevojshëm rehabilitimi fizioterapeutiko-klimatik në kohëzgjatje prej 30 ditësh për vitin e parë pas aksidentit dhe 15 tjera për vitin e dytë pas aksidentit.

Me dëgjimin dhe dhënien e mendimit të ekspertit Dr. N. F. neuropsikiatër nga Prizreni është konstatuar se në bazë të shiqimit në dokumentacionin mjekësor dhe ekzaminimit drejtpërdrejtë të paditësës është konstatuar se në aksident e njëjta ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe në këtë rast e ka humbur vetëdijen ku ka pësuar frikë sekondare të intensitetit të lartë një javë, intensitetit të mesëm 2 muaj, dhe të atij ultë ka zgjatur një vit.

Në rastin konkret në bazë të provave të lartëcekura gjykata pa mëdyshje ka vërtetuar se ka ndodhur aksidenti i komunikacionit ku lëndime trupore ka pësuar këtu paditësja, këtë gjendje faktike nuk e kanë mohuar as edhe përfaqësuesit të paditurit. Gjithashtu është vërtetuar se fajtor për këtë aksident ka qenë ngasësi i automjetit në të cilën ka qenë si bashkëudhëtare këtu paditësja. Nuk është kontestuese dhe se automjeti i cili ka shkaktuar aksidentin e komunikacionit ka qenë i siguruar tek e paditura. Sipas parimit të përgjegjësisë objektive në kuptim të nenit 897 LMD pala e paditur për dëmin e që ka pësuar pala paditëse dhe e drejta në kompensim bëhet në pajtim me dispozitat e ligjit për marrëdhënjet detyrimore e cila parasheh se duhet kompensuar dëmi sipas sigurimit. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkespadiisë pasi që ka tentuar të arrijë marrëveshje për kompensim për lëndime të pësuar, por ka kontestuar vetëm

lartësinë e kërkuar të kërkespadiës, andaj gjykata vetëm ka vlerësuar shkallën e lëndimeve të pësura dhe satisfacionin që do të ishte adekuat për lëndime. Kompensimi i dëmit jomaterial dhe material në të holla ka për qëllim satisfacionin për të dëmtuarin dhe jo që të arrihet ndonjë qëllim tjetër shoqëror i këtij kompensimi (nuk mund të komercializohen vlerat morale). Lartësinë e dëmit gjykata ka vlerësuar sipas mendimit të mjekut ekspert ortoped traumatolog dhe të ekspertit neuropsikijatër të cilët i kanë dhënë mendimet e tyre dhe janë deklaruar për të gjitha llojet e dëmit jomaterial të cilat gjykata i konsideron si mendime profesionale dhe të besueshme si dhe vlerësimin të lirë të gjykatës në kuptim të nenit 200LMD dhe 323 LPK .

Gjykata pjesërisht e ka aprovuar kërkesëpadinë dhe e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses në pjesën tjetër të saj, për shkak se, gjatë caktimit të lartësisë së kompensimit ka pasur parasysh edhe rëndësinë e të mirës së lënduar dhe qëllimi për të cilën ky kompensim dedikohet dhe ka ardhur në konkludim se vlerat e kërkuara nga ana e të autorizuarit të paditëses si dhe oferta e dhënë nga ana e të autorizuarit të paditurës nuk janë reale, pasi që njëra është tepër e lartë dhe tjetra tepër e ultë. Sa i përket kompensimit të dëmit material në bazë të dëftësive të propozuara si provë të njejtën nuk e ka aprovuar pasi që ishin pa emër, pa nënshkrim dhe vulë dhe gjykata nuk ka mund të provojë se ato janë përdorur dhe janë shpenzuar për shërim të paditëses. Gjithashtu sa i përket shërimit klimatiko-rehabilitues të cilën e ka vlerësuar eksperti se i është dashur për shërim paditëses, të njejtën gjykata nuk ka mund të aprovojë pasi që nuk ka pasur prova se paditësja është shëruar në ndonjë qendër rehabilituese, por se e njejtë vetëm ka parashtruar prova se është mjekuar në repartin e fizijatrisë në spitalin regional të Prizrenit. Bazuar në të gjitha këto gjykata vlerësimin e ka bërë në bazë të bindjes së lirë dhe vlerësimit të gjithëmbarshtëm të gjendjes faktike.

Nga të lartcekurat , gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet e procedurës janë caktuar në bazë të nenit 452.1 LPK duke pasur parasysh se pala e cila ka humbur kontestin duhet të paguajë palës fituese të gjitha shpenzimet të cila janë llogaritur sipas tarifës së avokatëve dhe shpenzimeve gjyqësore.

GJYKATA KOMUNALE NË PRIZREN

C.nr.465/08 me dt.19.12.2012

Gjyqtarja
Shpresa Emra

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur kundër këtij aktgjykimi ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kopjes, nëpërmjet kësaj Gjykate Gjykatës së Qarkut në Prizren.